



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.417/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Naim Mehulli**, në çështjen juridike të paditësit:

te cilën e përfaqëson

kundër të paditurës:

nga Mitrovica Rr.

p.nr, baza e kontestit: **Pasurim i pa bazë, vlera e kontestit 25,640.92**, në seancën e datës: 15.05.2018, konform nenit 148 të LPK-së bien këtë:

**A K T G J Y K I M**

**- në bazë të pohimit -**

- 1. APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe
- 2. OBLIGOHET** e paditura: nga Mitrovica që në emër të pasurimit te pa bazë t'ia paguaj paditësit Republika e Kosovës- shumën prej 25,640.92 euro, me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor,
- 3. OBLIGOHET** i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën prej 50 euro të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësi Republika e Kosovës-

te cilën e përfaqëson

me datë: 16.07.2015 ka parashtruar në

gjykatë padi kundër të paditurës

nga Mitrovica Rr. “

p.nr, për shkak të pasurimit te pa bazë në vlerë prej 25,640.92 euro.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 15.05.2018. Në këtë seancë e autorizuar e paditësit deklaroi se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, i propozoi Gjykatës që të njëjtën ta aprovoi si të bazuar duke e obliguar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumën e mjeteve 25,640.92 euro me kamat prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës i kërkoj dhe atë 50 euro për taks gjyqësore.

Në këtë seancë e paditura deklaroi se nuk e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, mirëpo unë të hollat është e vërtetë që i kame tërhequr në shumë prej 25.640.92 euro, por unë nuk e kame ditur se vendimi i Gjykatës Komunale dhe i Gjykatës së Apelit do të ndryshohen me aktgjykim të Gjykatës Supreme se për ndryshe po ta dija nuk do të i tërhiqja të hollat, tani për tani nuk kame asnjë mundësi për të i kthyer këto të holla, rrjedhja e procedurës ka qenë kështu fillimisht Gjykata

Komunale me ka kthyer ne vende te punës pastaj ne vitin 2013 Gjykata e Apelit e ka vërtetuar këtë vendim, ndërsa përmes gjykatës është bere ekzekutimi i vendimit te Gjykatës se Apelit ashtu qe me kane kthyer ne pune e po ashtu edhe te hollat përmes përmbarimit i kane realizuar, ndërsa me aktgjykim te Supremes janë ndryshuar aktgjykimet e me parshme dhe kërkesëpadia ime me është refuzua. Gjykata pas kësaj e informoi te paditurën për pasojat e mos kundërshtimit te padisë dhe te kërkesëpadisë nga ana e sajë mirëpo përkundër njoftimit për pasojat se gjykata ne baze te mos kundërshtimit te saj mund te bien aktgjykim ne baze te pohimit dhe me te cilat do te obligohet e paditura qe ti kthej mjetet prej 25.640.92 euro, e paditura deklaroi se nuk e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

Meqenëse kërkesëpadia e paditësit nuk u kundërshtua në aspektin e bazës nga ana e te paditurit, gjykata pa shqyrtim të mëtejme morri aktgjykim në bazë të pohimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejme në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet taksës për padi ne vlerë prej 50 euro

Andaj duke u bazuar në nenit 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,**  
**C.nr. 417/2015 Me dt.15.05.2018.**

**GJYQTARI,**  
**Naim Mehulli**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka te drejtë ankese në afat 15 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.